

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë penale e shkallës së parë, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarve D.M. nga fshati ....., komuna e Shtërpcës dhe S.S. nga ShtërPCA, të cilët sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2105-5/14 dt.29.12.2015 në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Bahri Hyseni dhe të akuzuarve D.M. dhe S.S., me dt.24.11.2016 solli dhe publikisht kumtoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

1. I akuzuari **D.M.** nga fshati ....., komuna e Shtërpcës data e lindjes.... në të njëjtin vend nga i ati S. dhe e ëma D., e gjinisë J., serb, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike.

2. I akuzuari **S.S.** nga ShtërPCA, data e lindjes.... në të njëjtin vend, nga i ati M. dhe e ëma S., e gjinisë Gj., serb, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer

shkollën e lartë kriminalistike, i martuar, babë i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike.

## **JANË FAJTOR**

Sepse me 30.05.2012 në Qendrën Regjistrimit të Automjeteve në Shtërpcë kanë vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtetë e paraparë të shërbej si provë në një dokument publik, në atë mënyrë që me qëllim që t'i ikin zhdoganimit dhe regjistrimit të rregullt të automjetit të markës “Golf III”, me ngjyrë të zezë metalike, me targa të regjistrimit ....., me numër të shasisë ....., viti i prodhimit 1996, përmes dokumentit të falsifikuar-librezës së qarkullimit ..... të shtetit të Serbisë, në emër të të pandehurit D.M. të cilin më parë e kishin falsifikuar, kanë arritur t'a regjistrojnë automjetin e tyre në QRA në Shtërpcë dhe janë pajisur me librezën e veturës ..... edhe pse e kanë ditur se i njëjti dokument është i falsifikuar.

- me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj gjykata, në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 6, 11, 34, 41, 42, 43, 44 dhe 64 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarit i

**G J Y K O N**

Të akuzuarit D.M. i shqiptohet dënimi me burg prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit S.S. i shqiptohet dënimi me burg prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Në kuptim të nenit 60 të KPK-së të akuzuarve u shqiptohet edhe dënimi plotësues gjegjësisht marrja e sendit dhe atë dokumentet e falsifikuara-libreza ....., libreza e qarkullimit ..... në emër të D.M..

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve gjyqësore-paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 60 €, gjegjësishtë secili nga 30 €, këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2105-5/14 dt.29.12.2015 me të cilën ka akuzuar D.M. dhe S.S., përshkak se në bashkëkryeje kanë kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata duke proceduar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së më dt.24.11.2016 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Bahri Hyseni dhe të akuzuarit D.M. dhe S.S..

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se të akuzuarit në afatin ligjor së bashku me ftesën për shqyrtim fillestar e kanë pranuar edhe aktakuzën sipas së cilës akuzohen.

Në shqyrtimin fillestar të akuzuarit janë udhëzuar në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPRK-së se kanë të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen e tyre ose të mos përgjigjet në pyetje të gjykatës, e nëse deklarohen nuk kanë për detyrë të inkriminojnë vehten apo të afërmit e tyre, e as ta pranojnë fajësinë, të mbrohen vetë apo përmes ndihmës juridike nga mbrojtësit sipas zgjedhjes së tyre si dhe të kundërshtojnë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave.

Lidhur me këtë të akuzuarit secili veç e veç kanë deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi të drejtat e tyre për të cilat janë udhëzuar nga gjyqtari, mbrojtës nuk do të angazhojnë, mbrojtjen do ta japinë vetë dhe do të përgjigjen në pyetjet e gjykatës.

Pas kësaj gjyqtari i kësaj çështje penale ka ftuar prokurorin e shtetit për të lexuar aktakuzën sipas së cilës janë ngarkuar të akuzuarit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe pasi gjyqtari është bindur se të akuzuarit i kanë kuptuar në tërësi të drejtat e tyre që u takojnë me ligj, se e kanë kuptuar edhe aktakuzën, të njëjtëve secilit veç e veç u ka dhënë mundësinë të deklarohen mbi fajësinë apo pafajësinë e tyre për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Lidhur me këtë i akuzuari D.M. ka deklaruar se e ndjenë vehten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se është e vërtetë ajo që është përshkruar në aktakuzë por krejt ajo çfarë ka ndodhur ka ndodhur nga mosdija pasi edhe vetë kanë qenë të lajthitur pasi në atë kohë këtu të gjithë i kanë regjistruar në këtë formë. Në fund të deklaratës së tij ka kërkuar nga gjykata që gjatë matjes së dënimit të ketë parasyshë të gjitha këto fakte dhe rrethana në të cilat është kryer kjo veprë penale dhe t'i shqipton një sanksion penal më të butë.

I akuzuari S.S. ka deklaruar se e ndjenë vehten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se është e vërtetë ajo që është përshkruar në aktakuzë por krejt ajo çfarë ka ndodhur ka ndodhur nga mosdija pasi edhe vetë kanë qenë të lajthitur pasi në atë kohë këtu të gjithë i kanë

regjistruar në këtë formë. Në fund të deklaratës së tij ka kërkuar nga gjykata që gjatë matjes së dënimit të ketë parasyshtë të gjitha këto fakte dhe rrethana në të cilat është kryer kjo vepër penale dhe t'i shqipton një sanksion penal më të butë.

Pas deklarimit të të akuzuarve mbi pranimin e fajësisë, gjyqtari u bind se të akuzuarit e kanë kuptuar në tërësi natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e kanë bërë vullnetarisht dhe është bazuar në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe në provat e prezantuara nga prokurori i shtetit, këtë edhe për arsyen se aktakuza nuk përmbanë ndonjë shkelje ligjore apo gabim teknik, për çka gjyqtari konsideron se pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të KPPRK-së dhe duke u bazuar në të njëjtin nen par.2 gjyqtari ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit Bahri Hyseni i cili ka deklaruar se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit pasi i njëjti pranim është bërë konform ligjit.

Gjyqtari i çështjes është bindur se janë vërtetuar të gjitha faktet mbi pranimin e fajësisë, kështu që duke u bazuar në nenin 248 par.4 të KPPRK-së ka sjellë aktvendim procedural mbi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe procedurën penale e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe nga provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës,

gjegjësisht nga libreza e qarkullimit ....., libreza e qarkullimiti ....., raporti mbi ekspertizën nga ana e Sektorit për Ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve i dt.20.03.2014 si dhe vërtetimi mbi marrjen e sendeve i dt.20.08.2014, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- se të akuzuarit me 30.05.2012 në Qendrën Regjistrimit të Automjeteve në Shtërpcë kanë vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtetë e paraparë të shërbej si provë në një dokument publik, në atë mënyrë që me qëllim që t'i ikin zhdoganimit dhe regjistrimit të rregullt të automjetit të markës “Golf III”, me ngjyrë të zezë metalike, me targa të regjistrimit ....., me numër të shasisë ....., viti i prodhimit 1996, përmes dokumentit të falsifikuar-librezës së qarkullimit .... të shtetit të Serbisë, në emër të të pandehurit D.M. të cilin më parë e kishin falsifikuar, kanë arritur t'a regjistrojnë automjetin e tyre në QRA në Shtërpcë dhe janë pajisur me librezën e veturës .... edhe pse e kanë ditur se i njëjti dokument është i falsifikuar.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjyqtari gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë e kryer në bashkëkryerje nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për çka të njëjtit i ka shpallë fajtorë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të dy të akuzuarit

gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tyre, sjelljen e tyre korrekte në procedurën penale, se të njëjtit kanë pasë sjellje të mira në të kaluarën dhe janë të njohur si përsëritës të këtyre veprave penale apo veprave të ngjashme. Andaj në bazë të këtyre rrethanave gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës të cilën të njëjtit e kanë kryer dhe pas këtij vlerësimi të akuzuarve u shqiptoi secilit veç e veç dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të akuzuarit në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejnë vepra tjera penale, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së sajë dhe personalitetit të të akuzuarve dhe se me të do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që të akuzuarit të mos kryejnë vepra penale dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 34 të KPK-së.

Konform nenit 60 të KPK-së gjykata të akuzuarve u ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, gjegjësisht marrjen e sendit dhe atë dokumentet e falsifikuara-libreza ....., libreza e qarkullimit ..... në emër të D.M..

Konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së të akuzuarit i ka obliguar të që në emër të shpenzimeve gjyqësore-paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 60 €, gjegjësishtë secili nga 30 €,



këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË  
SHTËRPCË**

**P.nr.98/2016 me datë 27.10.2016**

**Asistenti**

**Gjyqtari**

Muedin Rexhepi

Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar  
ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.